



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.39/2018
Prishtinë, më 11.9.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Glauk Konjufca, anëtarë.

Pjesëmarrës: Dardan Abazi – INDEP; Bekë Veliu – Koha Ditore, Edita Ferati – KDI, Shpresë Sejdiu – PSD dhe Dren Ajeti – Klubi i Prodhuesve Kosovar.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.7.2018;
3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2018;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë për kandidatet për kryesues të Bordit të ZRRE-së;
5. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2018;
6. Te ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.7.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2018

Kryetarja: Falënderoj anëtarët e komisionit për punën e tyre dhe të arriturat gjatë sesionit pranveror, me këtë rast paraqiti të arriturat e komisionit gjatë këtij sesioni. Komisioni ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të Planit të tij të Punës, të hartuar gjithnjë duke u bazuar në Strategjinë Legjislativë të Qeverisë dhe aktivitetet e tij. Këto aktivitete komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të grupeve të punës, monitorimit të zbatimit të ligjit, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, më qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre. Komisioni gjatë sesionit pranveror 2018 të Legjislaturës VI, realizoi gjithsej 28 (njëzet e tetë) mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe, komisioni në tërësi realizoi 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) aktivitete, me një mesatare prej 10 (dhjetë) aktiviteteve në muaj. Komisioni i realizoi mbledhjet dhe takimet e tij të rregullta, në të cilat u shqyrtuan rreth 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) pika të rendit të ditës. Mbledhjet e komisionit ishin publike dhe u monitoruan nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e komisionit e monitoruan përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE-së, NDI-së, INDEP dhe KDI-së, asociacione dhe organizata të tjera. Gjatë këtij sesioni, komisioni arriti që falë angazhimit të tij të bëjë të mundur shqyrtimin e 20 (njëzet) projektligjeve, dhe një Projektstatuti, ndërsa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi gjithsej 9 (nëntë) projektligje; 8 (tetë) projektligje janë proceduar për lexim të dytë në Kuvend, dhe 3 (tre) projektligje janë në procedurë të shqyrtimit, kanë kaluar leximin e parë në Kuvend, si dhe një Projektstatut është në procedurë të shqyrtimit në komision. Komisioni në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij sesioni shqyrtoi edhe raportet vjetore të agjencive të pavarura, të themeluara nga Kuvendi.

Pas debatit komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni miratoi Raportin e punës për sesionin pranveror 2018.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë për kandidatet për kryesues të Bordit të ZRRE-së

Kryetarja paraqiti emrat e dy kandidatëve të propozuar nga Qeveria për kryesues të Bordit të ZRRE-së, ku theksoj se në bazë të ligjit Qeveria duhet për një pozitë të sjellë se paku dy

propozime. Nder të tjera ajo theksoj se të dy kandidatet plotësojnë kriteret e vendosura me ligj, dhe hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Dardan Sejdiu theksoi se është problematike që të gjitha CV-të që vijnë, me përjashtime të vogla kanë përvojë punë në KEDS dhe pastaj dhe shumica prej tyre janë nga menaxhmenti i KEDS-it, dhe promovimi ndodh nga KEDS në ZRRE. Kjo është problem për faktin se një kompani ka informacione mbi nevojat e një korporate e cila ka monopol natyror dhe mund të shtyjë interesat e saj përmes këtyre informacioneve, dhe kemi një situatë kur të dy kandidatet tjerë plotësojnë kriteret dhe njëri prej tyre ka piket me të larta dhe po ashtu nuk kanë përvojën e punës në ZRRE dhe pa ndonjë arsytim nga ana e Qeverisë, nuk sjellën emrat e tyre në Kuvend, kjo për mua është shqetësuese. Si rrjedhojë me intereson ta dijmë se a mundet Qeveria të dërgojë më shumë se dy emra, ligji thotë se paku dy dhe kjo nuk e kufizon që Qeveria të sjellë tre e me shumë emra, kemi rastin e kandidatit i cili ka më së shumti pikë dhe emri i tij nuk është sjellë në Kuvend. Unë kërkoj që si Komision të kërkojmë nga Qeveria të sjellë edhe dy emrat tjerë si kandidat për kryesues të Bordit të ZRRE-së, të pastaj seanca le të vendosë.

Muharrem Nitaj theksoi se pasi nuk dihen arsyet e largimit të personit që ka pasur më shumë pikë, në aspektin rregullator Qeveria ka plotësuar kushtin ligjor duke dërguar dy emra, dhe është në diskrecionin e saj të vendosë për emrat.

Mimoza Kusari-Lila theksoi se nuk është rasti i vetëm kur Qeveria, qoftë për pozita të larta të shërbimit civil, apo edhe të agjencive të pavarura përzgjedh kandidat që kanë pak pikë. Gjithashtu mbështes propozimin e deputetit Sejdiu, për sjelljen edhe emrat e dy kandidatëve të tjerë për kryesues të Bordit të ZRRE-së. Ministrat e Qeverisë Haradinaj kanë votuar edhe dy emrat tjerë që të procedohen për Kuvend dhe me një vendim të Kryeministrit janë tërhequr dy emra të tjerë dhe kjo është shqetësuese.

Liburn Aliu theksoi se edhe ky mbështet idenë që të sjellën edhe emrat e dy kandidatëve që plotësojnë kriteret për kryesues të Bordit të ZRRE-së, si dhe të kërkohet sqarim më shkrim për procesin e të nominuarve.

Kryetarja: Ne nuk duam të japim kahe politike gjithë këtij debati, por si Komision do të kërkojmë përgjigje nga Qeveria që të japë arsytim rreth kësaj çështje se pse nuk janë sjellë edhe dy emrat tjerë të kandidateve për kryesues të Bordit të ZRRE-së në Kuvend.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Të kërkohet sqarim me shkrim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Zyra e Kryeministrit, lidhur me procedurat e nominimit të dy kandidatëve për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë; dhe, pse nuk janë dërguar në Kuvend katër kandidatët e propozuar nga Komisioni rekomandues „ad hoc” për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018

Kryetarja paraqiti para anëtareve të komisionit paraqiti draftin për planin e punës për sesionin vjeshtor 2018, të hartuar nga njësia mbështetëse e komisionit dhe kërkoj nga anëtarët e komisionit nëse ka dikush ndonjë propozim për ta pasuruar këtë draft të dërgojë komente me shkrim në mënyrë që të inkorporohen në planin e punës.

Hykmete Bajrami kërkoj që disa aktivitete të sqarohen dhe mos të mbesin vetëm ashtu të padefinuara si p.sh. vizitë sektorit prodhues, por të shënohet qartë së cilin sektor, ose të çështja e monitorimit të kontratave të lidhura nga institucionet publik, edhe kjo të shënohet qartë cila kontratë.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Konkluzion

Anëtarët e komisionit deri më 14.9.2018, të dërgojnë më email propozimet e tyre të njësia mbështetëse e komisionit.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Kryetarja njoftoj lidhur me një shkresë që ka dërguar sindikata e punëtorëve të KEDS-it, lidhur me shqetësimet e sindikalisteve që kanë të bëjnë me raportet konsultative që tani në këtë kohë i bënë ZRRE-ja. Ajo njoftoj se ka zhvilluar një takim me këtë sindikatë dhe kërkoj që t'i kthejmë përgjigje në kuadër të ligjit.

Deputetët u dakorduan që në mbledhjen e radhës të ftohet Bordi i ZRRE-së dhe përfaqësues të sindikatës së KEDS për të diskutuar lidhur me Raportet Konsultative për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale”, si dhe Raportin Konsultativ për përcaktimin e Faktorit të efikasitetit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA